



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 176, Datë 14.11.2019**

**MBI**

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË LIDHJEVE TË REJA NE SEKTORIN E GAZIT  
NATYROR.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; neni 16, pika 18; neni 32; neni 42 pika 3; neni 53 dhe neni 54 ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, nenit 16 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2019, mbasi shqyrtoi Relacionin e përgatitur nga Drejtoritë e ERE, me nr. 102/6 Prot, datë 07.11.2019, mbi miratimin e rregullores së lidhjeve të reja ne sektorin e Gazit Natyror,

**Konstatoi se:**

- Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, ERE ka përgjegjësi, mes të tjerave për të vendosur standardet dhe kërkesat minimale për cilësinë e shërbimit dhe furnizimit, veçanërisht për kohën që u duhet operatorëve të transmetimit e të shpërndarjes për të bërë lidhjet dhe riparimet, si dhe mbikëqyr zbatueshmërinë e tyre.
- Bordi i ERE-s me vendimin e Nr. 132, datë 29.08.2019, vendosi të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullores së lidhjeve të reja ne sektorin e Gazit Natyror”.
- Me shkresën nr. 566 Prot, datë 17.09.2019, ERE kërkoi nga palët e interesit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, ALBPETROL sh.a., ALBGAS sh.a., “TAP AG Albania” sh.p.k., “BALKGAZ” sh.p.k., “Anio Oil&Gas” sh.p.k., “Phoenix Petroleum” sh.a. dhe “C.G.C” sh.p.k., opinionionet dhe sugjerimeve në lidhje me këtë draft rregullore, brenda 15 ditëve nga marrja dijani.
- Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve dhe objeksioneve nga palët, rezultoi se është shprehur Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet shkresës me nr. 8113/1 Prot, datë 02.10.2019, e cila sugjeroi që, në këtë proces duhet patur në konsideratë edhe kërkesa e nenit 54 të Ligjit nr.

102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar, për sa ka të bëjë me Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes të miratuar nga ERE.

- Shoqëria "ALBGAZ" sh.a., nëpërmjet shkresës me nr. 96 Prot, datë 25.09.2019, është shprehur parimisht dakort me draft – Rregulloren e lidhjeve të reja ne sektorin e Gazit Natyror.
- Në tejkalim të afateve të parashikuara për marrjen e mendimeve të palëve të interesit mbi këtë akt, shoqëria "ALBGAZ" sh.a., nëpërmjet shkresës me nr. 96/1 Prot, datë 02.10.2019, ka dërguar opinion shtesë në lidhje me draft – Rregulloren e lidhjeve të reja ne sektorin e Gazit Natyror, ku shprehet dhe propozon që të bëhen disa ndryshime ne nenet: 3 pika 18, 5 pika 2, 12 pika 4, gërma c dhe 24 pika1.
- Shoqëria "TAP AG Albania" sh.p.k., me korrespondencën elektronike të datës 27.10.2019, është shprehur se:  
-TAP nuk kërkohet të sigurojë lidhje direkte për përdoruesit fundorë, TAP lidhet vetëm me OST-të kombëtare. Kjo vijon si nga ligji parësor i BE-së, ashtu edhe nga korniza specifike ligjore e TAP-it, e zhvilluar në përputhje me përjashtimin e dhënë TAP-it në vitin 2016.
- Sa i përket propozimit të MIE që duhet patur në konsideratë edhe kërkesa e nenit 54 të Ligjit nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror" të ndryshuar, për sa ka të bëjë me Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes të miratuar nga ERE, konstatojmë se:
  - Neni 54 i ligjit 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror", I ndryshuar parashikon se: *Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron akses në sistemin e shpërndarjes, brenda kufijve të kapaciteteve të shpërndarjes dhe rregullave teknike, në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes, të miratuar nga ERE*
  - ERE me vendimin e saj nr.7 datë 10.01.2018, ka miratuar Licencën tip të aktivitetit të shpërndarjes së gazit natyror.
  - Në vijim, bordi i ERE, me vendimin nr. 187, datë 10.11.2017, është shprehur për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.
  - Për sa më sipër, është e qartë që ERE ka zbatuar gjithë sa parashikuar në legjislacionin në fuqi, me qëllim krijimin e plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Nuk rezulton që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të ketë depozituar një kërkesë për miratim të kodit të Shpërndarjes.
- Sa i përket propozimeve të Albgaz sh.a. ato janë depozituar në tejkalim të afateve ligjore, nuk janë të arsyetuara e si të tilla nuk janë marrë në konsideratë.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Miratimin e "Rregullores së lidhjeve të reja në sektorin e Gazit Natyror". ( bashkëlidhur)

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**

## **RREGULLORE PER LIDHJET E REJA NË RRJET PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR**

### **PJESAI:TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1.**

##### **Fusha e veprimit dhe zbatueshmëria e Rregullores**

Kjo rregullore përcakton procedurën e aplikimit, kriteret për miratimin dhe realizimin e një *lidhjeje* të re ose modifikimin e një *lidhjeje* ekzistuese dhe përcaktimin e tarifave përkatëse për lidhjen e paisjeve të përdoruesit të rrjetit të transmetimit ose të shpërndarjes në sektorin e gazit natyror (më tej referuar si Rregullorja).

Kategoritë dhe nënkategoritë e *lidhjeve*, që janë objekt i kësaj Rregulloreje ose nuk përmbajnë asnjë *zgjatje të rrjetit*, ose janë vetëm *zgjatje të vogla të rrjetit* që janë të nevojshme për të furnizuar një përdorues të ri të rrjetit, ose për të modifikuar një *lidhjeje* ekzistuese me një rrjet transmetimi ose shpërndarjeje të gazit natyror, për të cilin kostot përkatëse i ngarkohen drejtpërdrejtë dhe rimburohen nga *aplikanti*.

Në rast se një aplikim për një *lidhjeje* kualifikohet si pjesë e planit vjetor të investimeve të Operatorit të rrjetit ose e planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të operatorit të rrjetit (TYNDP<sup>1</sup>), procesi i miratimit do të duhet të përmbushë kërkesat e Nenit 11 të Ligjit Nr.102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar, Vendimittë Këshillit të Ministrave nr. 713 datë 25.8.2010, dhe metodologjisë për vlerësimin e TYNDP të ERE-s dhe çdo legjislacioni tjetër në fuqi.

Kjo Rregullore është e zbatueshme për operatorët e rrjetit me qëllim sigurimin e *lidhjeve* të gazit për përdoruesit e rrjetit në zonat e tyre të shërbimit duke përcaktuar procesin e lidhjes.

#### **Neni 2.**

##### **Autoriteti**

Kjo Rregullore bazohet në Neni 16, pika 1 dhe pika 18, Neni 11, Neni 32, pika 1, Neni 42, Neni 43, Neni 53, Neni 54, dhe Neni 89 të Ligjit nr.102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar,.

#### **Neni 3.**

##### **Përkufizime<sup>2</sup>**

1. Me përjashtim të termave të përcaktuar më poshtë, çdo term, fjalë dhe shprehje e përdorur në këtë Rregullore do të ketë të njëjtin kuptim me ato të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi. Shprehje të tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin si vijon:

---

<sup>1</sup> TYNDP=Ten Year Network Development Plan

<sup>2</sup>Për lehtësinë e përdorimit, termat e përcaktuar në këtë rregullore në shumicën e kohës janë përdorur në shkrim italik.

2. Aplikant- një person fizik apo juridik, që është një përdorues ekzistues ose i ardhshëm i rrjetit, i cili paraqet një aplikim zyrtar në përputhje me këtë Rregullore për një *lidhje* në rrjetin e gazit të një Operatori i Rrjetit.
  3. Objekt - një objekt (banesë, shtëpi, ndërtesë, ambiente, fabrikë ose një grup prej secilës prej tyre që është subjekt i një aplikimi të vetëm) i cili tashmë është ose do të jetë gati të lidhet me rrjetin e gazit, bazuar në miratimin e *lidhjes* nga Operatori përgjegjës i Rrjetit
  4. Lidhja - instalimet, pajisjet, mjetet dhe materialet e përdorura në përputhje me miratimin për *lidhjen* për të siguruar furnizimin fizik të sigurt të gazit natyror sipas rastit:
    - i. për *lidhjen* e re të një objekti me rrjetin në pikën e lidhjes teknikisht dhe ekonomikisht më të afërt, përfshirë edhe pajisjen matëse ose;
    - ii. për modifikimin e një *lidhje* ekzistuese duke përfshirë rritjen e kapacitetit të saj;
  5. Për qëllimet e kësaj *Rregullore* termi *lidhje* përfshin të gjitha instalimet, pajisjet, mjetet dhe materialet dhe punime përkatëse të kryera për shtrirjen e rrjetit të Operatorit përgjegjës deri në *pikën e matjes* së aplikantit. Ajo përfshin gjithashtu, të gjithë ose pjesë të çdo zgjerimi ose përforcimi tjetër të nevojshëm më thellë në rrjet, siç merret parasysh në pjesën e tarifave të kësaj Rregulloreje, por ai nuk përfshin *instalimet e brendshme të gazit* nga ana e klientit jashtë *pikës së matjes*.
  6. Kapaciteti i Lidhjes - Kapaciteti maksimal (pik) i fuqisë i shprehur në MW për të cilin *lidhja* e kërkuar është projektuar dhe do të jetë e aftë të furnizoje.
  7. Pika e Lidhjes - vendndodhja fizike në rrjetin ekzistues të gazit natyror të Operatorit të Rrjetit që është pika më e afërt teknikisht dhe ekonomikisht me e justifikueshme nga ku fillon instalimi i *lidhjes* së aprovuar drejt *objekteve* të aplikantit.
  8. Instalimet brendshme të gazit –Të gjithë tubacionet dhe pajisjet lidhura të gazit natyror që ndodhen në ambientet e një *aplikanti*, nga krahu klientit të *pikës së matjes* dhe që nuk janë pjesë e rrjetit të gazit natyror të Operatorit të Rrjetit.
  9. Instalues i autorizuar i gazit - një person ose entitet i autorizuar sipas kërkesave ligjore përkatëse për të projektuar në mënyrë të sigurt, dhe/ose të instalojë, dhe/ose të riparojë, dhe/ose të ndryshojë ose të bëjë shtesatë një instalimi gazi ose të ndonjë pjese të tij.
  10. Pika e Matjes - vendndodhja fizike në rrjetin e gazit natyror në ambientet e një klienti, ku janë ose do të instalohen valvula mbyllesore kryesore, matësi i gazit dhe pajisjet dhe instalimet shoqëruese. *Pika e matjes* që përmban matësin dhe që i përket Operatorit të Rrjetit, është në të njëjtën kohë, pika e referencës në rrjetin e gazit natyror nga ku detyrimet dhe përgjegjësitë mbi rrjetin e tubacioneve për *instalimet e brendshme të gazit*, zhvendosen nga Operatori i Rrjetit tek klienti.
  11. Kostoja aktuale - kosto direkte që ka Operatori i Rrjetit për një *lidhje* të veçantë.
  12. Raporti i përdorimit të kapacitetit të rrjetit - *kapaciteti i lidhjes* i aprovuar që duhet t'i vihet në dispozicion aplikantit, i shprehur si përqindje e kapacitetit total të *tubacionit kryesor* të rrjetit të gazit të OS në të cilin do të lidhet *objekti i aplikantit*.
-

13. Tubacion Kryesor - një tub me presion të lartë, të mesëm ose të ulët, pjesë e rrjetit të gazit natyror, për orientimin dhe shpërndarjen e gazit natyror drejt tubacioneve më të vegjël për të arritur tek klientët fundorë dhe familjet.
  14. Zgjatje evogël errjetit - një *lidhje* e ndërtuar në zonën e shërbimit të Operatorit të Rrjetit, *distanca nga rrjetie* të cilit është brenda kufijve të mëposhtëm:
    - a. për *lidhjet standard*: deri në 100 m
    - b. për *lidhjet në grup*: deri në 500 m
    - c. për *lidhje të personalizuar*: deri në 1 kilometër në mënyrë radiale nga *pika e lidhjes* më e afërt e rrjetit me gaz natyror të Operatorit të Rrjetit.
  15. Distanca nga rrjeti - distanca reale midis *pikës së matjes të objektit të aplikantit* që synon të lidhet dhe *pikës së lidhjes* në rrjetin e gazit të Operatorit të Rrjetit, e matur përgjatë rrugës të tubacionit *lidhës* që do të ndërtohet.
  16. Çmimi i tregut - një çmim ose normë e arritur në treg, në kushtet më të favorshme në kohën kur *lidhja* është në shqyrtim ose ndërtim.
  17. Operatori i Rrjetit- një operator i sistemit të transmetimit dhe/ose shpërndarjes ose një operator i sistemit të kombinuar për një zonë të caktuar të shërbimit, i licencuar nga ERE në përputhje me nenet 23 pika 2 dhe nenin 23 pika 3 të Ligjit Nr. 102/2015 "Per Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar dhe Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Gazit Natyror,
  18. Lidhje standarde - një *lidhje* (tubacione polietileni ose çeliku) me një rrjet shpërndarës me një presion më të vogël se 6 bar pajisur me matës gazi dhe rregullator me kapacitet maksimal të përcaktuar prej 10 nm<sup>3</sup>/h, për të cilin përdoren pajisje, mjete dhe materialetë standardizuara dhe për të cilin kryhen punime standarde gjatë kohës ndërtimit.
  19. Lidhje në grup - një *lidhje* e një ndërtese shumë katëshe, e një *objekti* zyrash ose një grupim tjetër i klientëve të mundshëm të gazit në rrjet, me një presion pune prej p<6bar. Një *lidhje* e tillë ndërtohet nga *pika e lidhjes* së rrjetit deri në kufirin e pronës ku është instaluar pajisja rregulluese për të gjithë *objektin*, dhe prej andej në dy, ose më shumë pajisje matëse. Tarifat e *lidhjes në grup* shprehen për pajisje matëse dhe marrin parasysh përdorimin e ponderuar të *kapacitetit të lidhjes* dhe gjatësinë(të) respektive.
  20. Lidhje e personalizuar – një *lidhje* në:
    - a. Rrjetine Transmetimit; ose
    - b. Rrjetin e Shpërndarjes, kur presioni tejkalon 6 bar, ose atje ku pajisjet maksimale të matjes/rregullimit mundësojnë tejkalimin e kapacitetit 100 kW.
  21. Lidhja e rasteve të veçanta- në kuptimin e kësaj *Rregullore*, rastet e mëposhtme konsiderohen se janë raste të veçanta për përcaktimin e tarifave të *lidhjes*:
    - a. Modifikimi i një lidhje ekzistuese;
    - b. Rilidhja e një *objekti* në rrjet pas një shkëputjeje të detyruar nga rrjeti; dhe
-

- c. *Lidhja* brenda rrjetit të të njëjtit Operator Rrjeti e një përdoruesi, i cili ka patur më herët një *lidhje standarte* ose pajisjet matëse si pjese e një *lidhje ne grupnë* një vend tjetër, në rast zhvendosjeje ose prishjeje të *objektit* të lidhur.
  - d. Kostot e lidhjes në gjysëm-thellësi të rrjetit- një tarifë hyrje që i ngarkohet *aplikantit* vetëm një herë, e cila mbulon kostot që lidhen me efektet që shkakton *lidhja ne thellesi* të rrjetit të gazit natyror dhe llogaritet si një funksion i *raportit të përdorimit të kapacitetit të rrjetit*.
22. Marrëveshja e Lidhjes - një marrëveshje Tip ose e dakortësuar mes palëve e lidhur midis Operatorit të Rrjetit dhe *aplikantit* që ka të bëjë me realizimin e *lidhjes*, siç përshkruhet më tej në nenin 15.

#### **Neni 4.**

##### **Detyrimi për dhënien e një lidhje në rrjet**

1. Në varësi të dispozitave të pikës 3 të këtij neni si dhe kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në këtë *Rregullore*, çdo *aplikant* ka të drejtë e *lidhjes* me rrjetin e gazit natyror të operatorit të licencuar për zonën përkatëse të shërbimit.
  2. *Lidhja* për të gjithë përdoruesit e rrjetit të gazit do të sigurohet në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese dhe do të bazohet në një *marrëveshje lidhjeje Tip apo* të dakortësuar.
  3. Operatori i Rrjetit ka të drejtë të refuzojë një kërkesë për një lidhje apo modifikim të lidhjes nëse *aplikanti* ose përdoruesi i rrjetit:
    - a. nuk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë *Rregullore*,
    - b. nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat teknike dhe standardet, siç parashikohet në Nenin 8,
    - c. nuk lejon që Operatori përgjegjës i rrjetit të hyjë në *objektet*, siç parashikohet në Nenin 5,
    - d. nuk i plotëson kriteret për vlerësimin e një aplikimi, siç parashikohet në Nenin 7,
    - e. është debitor dhe nuk ka shlyer detyrimet e mëparshme ndaj Operatorit të Rrjetit,
    - f. nuk është i gatshëm të paguajë tarifat e *lidhjes* të llogaritura në përputhje me këtë *Rregullore* (Pjesa III),
    - g. nuk ka shlyer pagesën(at) për *lidhjen* përkatëse siç është rënë dakord në *marrëveshjen e lidhjes* me Operatorin e Rrjetit.
-

- h. Rrjeti i Operatorit përgjegjës ka kapacitet të pamjaftueshëm për të plotësuar kërkesën e *aplikantit* dhe nuk është efciente nga ana ekonomike që ta zgjerojë atë.
4. Në rast se Operatori përgjegjës, bazuar në vlerësimin e tij vendos që *lidhja* të mosmiratohet, ka detyrimin t'i japë *aplikantit* një shpjegim të hollësishëm me shkrim, duke i paraqitur të gjitha arsyet teknike, operacionale dhe ekonomike për të cilat është refuzuar miratimi ilidhjes.
5. Në rastet e një refuzimit në kushtet e lartë përmendura, shpjegimi do ti bëhet me dije ERE-s dhe mund të ankimohet në ERE nga *aplikanti*.

#### **Neni 5.**

##### **E drejta e aksesit në objektet e aplikantit**

1. Kur aplikon për një *lidhje*, *aplikanti* ka detyrimin t'i garantojë Operatorit përgjegjës të rrjetit, të drejtën për të hyrë në *objektet* e tij, në kohën e dakordësuar nga të dy palët, dhe merr masat e nevojshme në mënyrë që ky i fundit, të mund të verifikojë dhe vlerësojë të gjitha rrethanat që lidhen me projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e mëtejshëm të *lidhjes*, përfshirë kontrollin *instalimevetë brendshme të gazit të aplikantit* sipas Nenit 9.5 dhe 9.6 të kësaj *Rregulloreje*.
2. Operatori përgjegjës i Rrjetit mund të refuzojë ekzekutimin e një *lidhjeje* në rast se klienti nuk garanton aksesin e përfaqësuesit të Operatorit Përgjegjës të Rrjetit në ambjentet e *aplikantit* për qëllimet e përmendura më lart.

#### **Neni 6.**

##### **Kategoritë e Lidhjeve**

1. Në varësi të presionit të rrjetit në *pikën e lidhjes, kapacitetit të lidhjes, metodës së lidhjes* dhe numrit të matësve të instaluar në një *objekt* të vetëm dhe të lidhur me një pajisje rregullimi, *lidhjet* do të grupohen në katër kategori:
  - a. *Lidhje standarde;*
  - b. *Lidhje në grup;*
  - c. *Lidhje e personalizuar;*
  - d. *Lidhjesipas një rasti specifik.*

Në rastet e një numrite konsiderueshëm *aplikantësh*, ose *aplikantësh*potencialë për një kategori të caktuar *lidhjeje*, e cila nuk përmendet në paragrafin (1) të këtij neni, i bëhet me dije Operatorit të Rrjetit dhe ky i fundit do të marrë në konsideratë përcaktimin e llojeve të *lidhjeve* dhe/ose shërbimeve standarde shtesë në përputhje me parimet e kësaj *Rregullore*. *Kategori të reja lidhjeje, të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, do të konsiderohen pjesë e kësaj rregulloreje vetëm pas paraqitjes së kërkesës së argumentuar të Operatorit të Rrjetit dhe miratimit të ERE-s. Vetëm pasi ERE të ketë miratuar ndryshimet e mësipërme, informacionet që kanë të bëjnë me këto lloje lidhesh do të vihen në dispozicion të palëve të interesuara në faqen e internetit të Operatorit të rrjetit, së bashku me informacionin për të gjitha kategoritë e përfshira në këtë rregullore.*

---



## Neni 7.

### Kriteret e vlerësimit të një Aplikimi për Lidhje

1. Vlerësimi i një kërkesë për *lidhje* do të bëhet nga Operatori Përgjegjës i Rrjetit rast pas rasti.
  2. Operatori përgjegjës i rrjetit do t'i lejojë *aplikantin* të plotesojë informacionet që mungojnë ose do t'i kërkojë *aplikantit* sqarime shtesë nëse është e nevojshme brenda afateve të arsyeshme.
  3. Koha e përgjithshme për miratim dhe modifikimin e një *lidhjeje* nuk mund të tejkalojë 2 muaj nga paraqitja e parë e aplikimit, përveç nëse është arritur një marrëveshje e shkruar për një zgjatje të këtij afati midis Operatorit të Rrjetit dhe *aplikantit*.
  4. Bazuar në veçoritë e *lidhjes*, kufijtë tregues të parashikuar nga përkufizimi i *zgjatjes të vogël të rrjetit* dhe kriteret në paragrafin (5) më poshtë, Operatori përgjegjës i rrjetit do të vlerësojë përputhshmërinë e aplikimit me kërkesat e Nenit 12 të kësaj *Rregullore*. Nëse sipas gjykimit të Operatorit të Rrjetit, *lidhja* e kërkuar do të ketë një ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e ardhshëm të rrjetit të gazit, Operatori i Rrjetit do t'i japë *aplikantit* me shkrim arsyet e hollësishme pse rasti specifik nuk kualifikohet si *lidhje* dhe t'a këshillojë dhe mbështesë atë të veprojë sipas Nenit 1.3 të kësaj *Rregullore*.
  5. Në vlerësimin e një kërkesë për *lidhje*, Operatori i Rrjetit do të sigurojë përputhshmërinë me kërkesat e:
    - a. Ligjit Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së instalimeve nën presion",
    - b. Rregullat Teknike të miratuara nga Vendimet e Këshillit të Ministrave që garantojnë funksionimin e sigurt të pajisjeve dhe instalimeve të gazit natyror,
    - c. Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Matjes,
    - d. Standardet e zbatueshme,
    - e. Çdo kërkesë tjetër ligjore,
  6. dhe gjithashtu do të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:
    - a. Kërkesat e parashikuara në Nenin 4.3 të kësaj *Rregullore*,
    - b. Vendndodhjen e *objektit* për të cilin kërkohet *lidhja* duke përfshirë shtrirjen dhe koordinatat e kufijve të tij,
    - c. *Largësinë nga rrjeti*,
    - d. Kapacitetin e disponueshëm të rrjetit të Operatorit përgjegjës në atë zonë,
    - e. Aspektet e sigurisë gjatë punimeve të zbatimit dhe fazën operative të *lidhjes* së kërkuar, përfshirë kohën e përgjigjes në rast të situatave emergjente,
-

- f. Përputhshmërinë e parametrave teknikë (diametri, kapaciteti, presioni, etj) të *lidhjes* së kërkuar me planin afatgjatë të zhvillimit të rrjetit në zonën përkatëse,
- g. Aplikimet aktuale dhe potenciale të ardhshme për t'u lidhur në të njëjtën *pikë lidhjeje*,
- h. Ndikimin e mundshëm në besueshmërinë e furnizimit me gaz natyror duke siguruar që asnjë *lidhje* nuk do të shkaktojë ndonjë efekt negativ tek përdoruesit ekzistues të rrjetit, dhe se *lidhja* nuk duhet të çenohet nga ndonjë prej përdoruesve ekzistues të rrjetit,
- i. Kërkesat e standardit IOS 18001<sup>3</sup>,
- j. Analizat kosto – përfitime të operatorit të Rrjetit (financiare, ekonomike, sociale) të *lidhjessë* realizuar, në përputhje me parimet e përcaktuara nga kjo *Rregullore*.

#### **Neni 8.**

##### **Kërkesat teknike për projektimin dhe zbatimin e nje lidhje**

1. Çdo *lidhje* është pjesë e rrjetit të gazit natyror të Operatorit të Rrjetit dhe është përgjegjës për zbatimin dhe përputhshmërinë me të gjitha kërkesat minimale teknike dhe të sigurisë që janë në fuqi, përfshirë:
  - i. Rregullat Teknike dhe të Sigurisë në sektorin e gazit natyror, të miratuara, bazuar në Nenin 10 të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror",
  - ii. Standardet Evropiane në sektorin e gazit natyror,
  - iii. Standardet e kompanisë OS,
  - iv. Kodet e rrjetit,
  - v. Çdo rregull dhe normë dhe çdo legjislacion në fuqi.

#### **Neni 9.**

##### **Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Rrejtit**

1. Në përputhje me Nenin 41 dhe Nenin 53 të Ligjit Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", Operatori i Rrjetit ka përgjegjësinë për projektimin e sigurt, prokurimin, ndërtimin, testimin, komisionimin dhe vënien në punë të një *lidhjeje* të aprovuar.
2. Edhe kur nënkontraktin punimete *lidhjes*, Operatori i Rrjetit mbetet përgjegjës dhe siguron që zgjedhja e pajisjeve, mjeteve dhe materialeve si dhe zbatimi i punimeve të *lidhjes* të kryhen në përputhje me legjislacionin aktual dhe standardet e veta të Rrjetit.
3. Operatori i Rrjetit do të ofrojë bashkëpunimin më të mirë për çdo *aplikant* të interesuar për një *lidhje* në përputhje me dispozitat dhe afatet e kësaj *Rregullore*.

4. Operatori i Rrjetit është përgjegjës për të gjithë sistemin gazit natyror deri në *pikën e matjes*. Jashtë *pikës së matjes*, përgjegjësia i mbetet *aplikantit*.
5. Operatori i Rrjetit do të mbetet përgjegjës për kryerjen e kontrolleve teknike të *instalimeve të brendshme të gazit* në të cilat Operatori i Rrjetit shpërndan/transmeton gaz natyror, duke siguruar që ato të funksionojnë në përputhje me rregulloret teknike në fuqi.
6. Operatori i Rrjetit bën kontrollin e *instalimeve të brendshme të gazit* para dhe gjatë vendosjes në operim të *lidhjes* dhe në çdo kohë tjetër kur konsiderohet e nevojshme, duke njoftuar paraprakisht *aplikantin*.
7. Pasi vënia në punë të përfundojë me sukses dhe të dokumentohet, e gjithë përgjegjësia për *instalimet e brendshme të gazit* bie mbi klientin të cilit i është siguruar lidhja në përputhje me Nenin 10.5 të kësaj *Rregullore*.
8. Gjatë zbatimit të punimeve civile, Operatori i Rrjetit do të sigurojë që të gjitha rregullat e autoriteteve qendrore dhe vendore janë respektuar dhe do të sigurojë që *aplikanti* nuk do të dëmtohet nga ndonjë pasojë e veprimeve të papështatshme të tij.

#### **Neni 10.**

##### **Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Aplikantit**

1. *Aplikanti* do të lejojë hyrjen e përfaqësuesve të Operatorit përgjegjës të Rrjetit në objektet e tij, siç parashikohet në Nenin 5 , 9.5 dhe 9.6 të kësaj *Rregullore*.
  2. *Aplikanti* do të sigurojë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, përfshirë çdo leje të nevojshme për realizimin/modifikimin e *lidhjes* së kërkuar. Në rast të kundërt kjo mund të rezultojë në refuzimin e *kërkesës*.
  3. Një *aplikant* mund të aplikojë për një *lidhje, apo modifikim të lidhjes ekzistuese* drejtperdrejtë, ose nëpërmjet një pale të tretë, të autorizuar nga ai.
  4. Në përputhje me Nenin 17.1 të kësaj *Rregullore* gjatë vlerësimit të projektit të *lidhjes* dhe ofertës financiare të bërë nga Operatori i Rrjetit, *aplikanti* mund të përfshijë një *instalues të autorizuar të gazit*me shpenzimet e veta.
  5. *Aplikanti* siguron që ndërtimi ose modifikimi i çdo *instalimi të brendshëm të gazit* në objektet e tij,do të kryhet vetëm nga një *instalues i autorizuar i gazit* në përputhje me Rregulloret Teknike dhe rregullat dhe normat në fuqi dhe se *instalimet e brendshme të gazit* do të përdoren në përputhje me udhëzimet përkatëse.
  6. Për projektimin dhe zbatimin e punimeve të *instalimeve të brendshme të gazit* në objektin e *aplikantit*, *aplikanti* mund ose:
    - i. të bjerë dakort me Operatorin përgjegjës të rrjetit për të zgjeruar *marrëveshjen e lidhjes* për të përfshirë edhe ndërtimin e *instalimeve të brendshme të gazit* brenda *objektit të aplikantit* bazuar në çmimet tregut, ose.
    - ii. të kryejë vetë ndërtimin e *instalimeve të brendshme të gazit*, duke përdorur një *instalues të autorizuar të gazit*. Pavarësisht kësaj zgjedhjeje, Operatori
-

përgjegjës i Rrjetit ka të drejtë dhe përgjegjësi të kryejë detyrat e parashikuara në Nenin 9.5 dhe 9.6.

7. *Aplikantinuk* do të ngarkojë Operatorin përgjegjës të rrjetit me asnjë përgjegjësi dhe detyrim që mund të vijë nga dëmet e shkaktuara nga çdo ndërhyrje e paautorizuar e bërë në *instalimet e brendshme të gazit brenda objektit* dhe/ose përdorimi i papërshtatshëmi instalimeve në fjalë.

## **PJESAI: PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË ZBATIMIT**

### **Neni 11.**

#### **Informimi i publikut dhe dorëzimi i aplikimit**

1. Çdo palë e interesuar për një *lidhje* do të jetë në gjendje të tërheqë udhëzimet dhe informacionet për *lidhjen* në faqen e internetit të Operatorit të Rrjetit, dhe/ose të kontaktojë drejtpërdrejtë me Operatorin e Rrjetit, dhe/ose me anë të korrespondencës me shkrim, duke kërkuar detajet dhe shpjegimet e nevojshme për *lidhjen* e synuar.
  2. Operatori i Rrjetit do të sigurojë që informacioni dhe shpjegimet e kërkuara do të jepen pa pagesë, brenda 7 ditëve nga marrja e shprehjes së interesit të *aplikantit*.
  3. Brenda 12 muajve nga miratimi i kësaj *Rregullore*, Operatorit të Rrjetit do të publikojë në faqen e saj të internetit në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme, format të mirëstrukturuar dhe lehtësisht të aksesueshëm e të përdorshëm:
    - a. përfitimet e përdorimit të gazit natyror së bashku me rregulloret dhe udhëzimet për përdorimin e sigurt të tij,
    - b. një hartë të përditesuar dhe të saktë të rrjetit të gazit natyror në zonën e shërbimit të Operatorit të Rrjetit dhe karakteristikat kryesore të tij,
    - c. kategoritë e *lidhjeve* të vëna në dispozicion për përdoruesit e rrjetit së bashku me karakteristikat teknike standarde dhe kërkesat minimale për secilën prej tyre,
    - d. udhëzimet, shpjegimet dhe formatet e nevojshme për t'u përdorur kur aplikohet për një *lidhje*,
    - e. listën e informacionit të kërkuar për secilën kategori *lidhjeje*, siç parashikohet në Nenin 12,
    - f. lejet e nevojshme të marra, ose për t'u marrë nga Operatori i Rrjetit dhe lejet e nevojshme që duhet të merren nga *aplikanti*,
    - g. formati i aplikimit që duhet të plotësohet për secilën kategori të *lidhjes*,
    - h. formati i *marrëveshjes se lidhjes* për kategoritë e ndryshme të *lidhjes*,
    - i. koha e pritshme për secilin hap të procedurës së *lidhjes*,
-

- j. listën e *instaluesve të autorizuar të gazit* së bashku me detajet e kontaktit të tyre që *aplikanti* mund të përdorë për të përfunduar *instalimet e brendshme të gazit* ose për vlerësimin e ofertës,
  - k. kostot e aprovuara për *lidhjet* standarde dhe kostot indikative për kategoritë e tjera të llogaritura në përputhje me Pjesën III të kësaj *Rregullore*,
4. Formulari i aplikimit për njërën nga kategoritë e *lidhjes*, siç parashikohet në nenin 6 të kësaj Rregulloreje, mund të paraqitet nga *aplikanti* ose:
- a. online, duke ndjekur udhëzimet e dhëna në faqen e internetit të Operatorit të Rrjetit. Në raste të tilla, kopjet origjinale të printuara (ose në masën që është e nevojshme - kopje të noterizuar) të aplikimit dhe dokumentacionit mbështetës gjithashtu do të dorëzohen ose dërgohen në zyrat e Operatorit të Rrjetit ose,
  - b. duke dorëzuar drejtpërdrejt në zyrat e Operatorit të Rrjetit një kopje origjinale ose të noterizuar të formularit të plotësuar të aplikimit dhe dokumentacionit mbështetës.
5. Aplikimi dhe ndjekja e tij regjistrohet në bazën e të dhënave të *lidhjes* së Operatorit të Rrjetit, siç parashikohet në Nenin 18 të kësaj *Rregullore*.

## Neni 12.

### Dokumentat e kërkuar për një Aplikim

1. Për të gjitha kategoritë e *lidhjeve*, një kërkesë do të përmbajë informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:
- a. Letra e aplikimit për *lidhjen* që specifikon njërën nga kategoritë e *lidhjes* të listuara në Nenin 6.
  - b. Kopje e Dokumentit të Identitetit (ID) ose e pasaportës së pronarit të shtëpisë, ose.
  - c. Fotokopje e Numrit Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) së bashku me IDtë administratorit në rastin e një personi që ushtron aktivitet ekonomik.
  - d. Detajet e kontaktit të individit përgjegjës, ose të administratorit në rastin e një kompanie.
  - e. Adresa e *objektit* për të cilin paraqitet aplikimi për *lidhje*.
  - f. Marrëdhënia e pronësisë me *objektin*; çertifikatë pronësie të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, kontrata e blerjes, akti i dhurimit, kontrata e qirasë etj.
  - g. Paraqitja e *objektit* në shkallë 1: 1000 (dy kopje), përfshirë koordinatat e kufijve të tij.
-

- h. Koncepti, ose projekti i para fizibilitetit, ose projekti teknik i *lidhjes* së kërkuar, nëse ka.
                - i. Identitetin e përfaqësuesit të autorizuar ose *instaluesit të autorizuar të gazit* nëse aplikohet.
2. Një kërkesë për një *lidhje standarde*, përveç informacionit të përgjithshëm sipas paragrafit (1) më lart, gjithashtu do të përmbajë:
  - a. Informacion mbi qëllimin e përdorimit të gazit, që mund të jetë për gatim, ngrohje ose nxehje të ujit,
  - b. Një vlerësim i konsumit vjetor i përlllogaritur në metra kub ose në kilovat-orë gaz,
  - c. Leje(t), të cilat *aplikanti* i ka marrë tashmë në lidhje me këtë kategori *lidhjeje*.
3. Një kërkesë për *lidhje në grup*, përveç informacionit të përgjithshëm sipas paragrafit (1) më lart, gjithashtu përmban:
  - a. Vërtetim për pagesën e tarifës së aplikimit prej 50,000 lekësh shqiptare,
  - b. Informacione mbi natyrën e objekteve që do të furnizohen me gaz natyror,
  - c. Numri i pajisjeve matëse që do të instalohen që në fillim dhe zhvillimi i pritshëm i numrit të pajisjeve të reja matëse që do të lidhen në degëzimin e shumëfishtë,
  - d. Numri maksimal i pajisjeve matëse që mundet të lidhen nëdegëzimin e shumëfishtë,
  - e. Debiti maksimal për gaz (peak) i kërkuar,
  - f. Një vlerësim i profilit ditor dhe vjetor i konsumit të gazit dhe ndryshimi i tij i pritshëm me kalimin e kohës,
  - g. Kontrata e furnizimit ose një marrëveshje tippapraake me furnizuesin e mundshëm të gazit,
  - h. Niveli i dëshiruar i presionit,
  - i. Leje(t), të cilat *aplikanti* i ka marrë tashmë në lidhje me këtë kategori *lidhjeje*,
  - j. Leje(t), të cilat *aplikanti* është gati t'i marrë, ose të ndihmojnë Operatorin e Rrjetit në marrjen e tyre.
4. Një kërkesë për *lidhje të personalizuar*, përveç informacionit të përgjithshëm në paragrafin (1) më lart, duhet gjithashtu të përmbajë:
  - a. Vërtetim për pagesën e tarifës së aplikimit prej 100,000 lekësh.
  - b. Informacione të përgjithshme për veprimtarinë e biznesit të *aplikantit* dhe përdorimin e meparshëm dhe të ardhshëm të gazit dhe/ose ndonje lloj tjetër të energjisë.
-

- c. Informacione për natyrën e *objekteve* që do të furnizohen me gaz natyror.
- d. Kontratentip të furnizimit me gaz dhe identitetine furnizuesit.
- e. Sasia maksimal për gaz (peak) i kërkuar.
- f. Një vlerësim i profilit ditor dhe vjetor të konsumit të gazit.
- g. Nivelin e dëshiruar të presionit.
- h. Leje(t), të cilat *aplikanti* tashmë i ka marrë për realizimin e *lidhjessë* tij.
- i. Leje(t), të cilat *aplikanti* është gati të marrë, ose të ndihmoje për marrjen e tyre për realizimin e *lidhjes* së tij.

5. Një kërkesë për një *lidhje të një rasti të vecantë*, përveç informacionit të përgjithshëm në paragrafin (1) më lart, duhet gjithashtu të përmbajë:

- a. Vërtetim për pagesën e tarifës së aplikimit prej 10,000 lekësh.
- b. Informacione për natyrën e *objekteve* që do të furnizohen me gaz natyror.
- c. Debiti maksimal për gaz (peak) i kërkuar.
- d. Një vlerësim i profilit ditor dhe vjetor të konsumit të gazit.
- e. Nivelin e dëshiruar të presionit.
- f. Leje(t), të cilat *aplikuesi* tashmë i ka marrë për realizimin e *lidhjes* së tij.

### Neni 13.

#### Afatet për përfundimin e procesit të aplikimit

1. Pas paraqitjes së një kërkesë për *lidhje*, siç parashikohet në Nenin 11 dhe Nenin 12 të kësaj Rregullore, Operatori i Rrjetit do të lëshojë menjëherë një konfirmim për pranimin e kërkesës, duke përmendur kohën e paraqitjes së tij dhe do të sigurojë informacione standarde në lidhje me skedulën e parashikuar për vlerësimin e tij dhe hapat e tjerë parashikues të procesit, duke përfshirë kohën, lejet për të marrë etj.
  2. Jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga paraqitja e aplikimit, Operatori Rrjetit do të:
    - a. në rast të mungesave në dokumentacion, informojë *aplikantin* të paraqesë çdo të dhënë dhe/ose informacion të munguar që është identifikuar gjatë vlerësimit paraprak të kryer nga Operatori i Rrjetit. *Aplikanti* duhet të sigurojë informacionin e munguar dhe sqarimet brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës nga Operatori i Rrjetit.
    - b. konfirmojë plotësinë e aplikimit dhe bie dakort me *aplikantin* për ditën kur eksperti i Operatorit të Rrjetit mund të vizitojë vendin ku kërkohet *lidhja*. Me përjashtim
-

- të rastit kur kushtete motit nuk lejojnë kryerjen e vizitës në terren, ajo duhet të realizohet jo më vonë se 7 ditë kalendarike pas ditës së marrjes së përgjigjes nga OS.
- c. Informojë *aplikantin* që çështja nuk kualifikohet si një *lidhje* dhe e udhëzon atë që të veprojë në bazë të Nenit 7.4 dhe Nenit 1.3 të kësaj *Rregullore*.
3. I gjithë procesi për plotësimin e një aplikimi për *lidhje*, përfshirë vizitën në terren dhe takimet me *aplikantin*, në asnjë rast nuk do të zgjasë më shumë se 30 ditë nga dita e parë e dorëzimit të tij.

#### Neni 14.

##### Projekti Teknik dhe Procesi i Vlerësimit të Kostos

1. Pas mbledhjes së të gjitha informacioneve që mungojnë, sqarimeve shtesë, vizitës në terren dhe çdo takimi tjetër me *aplikantin*, Operatori i Rrjetit do të ndërmarrë përgatitjen e projektit teknik dhe vlerësimin e kostos për anën e tij perkundrejt *pikës së matjes*, dhe pastaj do t'ia paraqesë ato *aplikantit* brenda afateve vijuese nga marrja e aplikimit të plotë për *lidhje*:
- 1 muaj për një *lidhje standarde*.
  - 3 muaj për një *lidhje në grup*.
  - 4 muaj për një *lidhje të personalizuar* ose ashtu si është rënë dakord ndërmjet *aplikantit* dhe Operatorit të Rrjetit në rast të një *marrëveshjeje lidhjeje* të negociuar.
  - në varësi të situatave specifike për një *lidhje të një rasti të veçantë* ose ashtu si është rënë dakord ndryshe ndërmjet *aplikantit* dhe Operatorit të Rrjetit në rast të një *marrëveshjeje për lidhje* të negociuar.
2. Projekti teknik dhe vlerësimi i kostos së *lidhjes* do të përgatiten duke marrë parasysh që:
- kur është e mundur, do të merret në konsideratë më shumë se një mundësi alternative teknike për lidhjen.
  - në përputhje me Pjesën III të kësaj *Rregullore*, vlerësimi i kostos së projektit të *lidhjes* do të bëhet në bazë të *çmimeve aktuale të tregut* për secilin nga opsionet e *lidhjestë* zgjedhur.
  - zgjedhja e opsionit më efikas midis alternativave të ndryshme do të bazohet në kriteret e dhëna në Nenin 7 dhe Pjesën III të kësaj *Rregullore*.
3. Në rast se Operatorit të Rrjetit ofron zbritje ose lehtësime për një *aplikant*, të njëjtat zbritje dhe/ose lehtësime do t'i ofrohen gjithashtu çdo *aplikanti* tjetër për *lidhje*.
-



## Neni 15.

### Oferta e Lidhjes

1. Pas zgjedhjes së alternativës më të mirë dhe përfundimit të projektit të *lidhjes* dhe vlerësimit të kostos siç parashikohet në Nenin 14 më lart, Operatori i Rrjetit do të informojë *aplikantin* me shkrim për:
  - a. Miratimin e *lidhjes*. Në këtë rast OS do t'i japë *aplikantit* një ofertë për ndërtimin e projektit të *lidhjes* që do të përbëhet nga:
    - i. vendndodhjet e sakta të *pikës së lidhjes* dhe të *pikës së matjes*
    - ii. projekti teknik
    - iii. *kostot e lidhjes në gjysëm thellësi tërrjetit*
    - iv. kosto totale e projektit e llogaritur në përputhje me Pjesën III të kësaj *Rregulloreje*
    - v. draftin e *marrëveshjes së lidhjes*
    - vi. garancinë bankare të kërkuar
    - vii. kohën e propozuar për zbatimin e *lidhjes*
    - viii. skedulën e pagesave që duhet të bëhen nga *aplikuesi*
  - b. Refuzimin e kërkesës për *lidhje* së bashku me arsyetimin e hollësishëm për një vendim të tillë, përfshirë informacionin për mënyrën e apelimit pranë Operatorit të Rrjetit dhe më pas në ERE.
2. Pas marrjes së vendimit të OS, siç parashikohet në paragrafin më lart, brenda 15 ditëve kalendarike, *aplikanti* kur merr një ofertë mund :
  - a. të pranojë ofertën duke firmosur dhe derguar *marrëveshjen e lidhjes* në Operatorin e Rrjetit dhe duke ekzekutuar këstin e parë dhe duke përmbushur të gjitha aspektet e tjera siç parashikohet në *marrëveshjen e lidhjes*, ose
  - b. të kundërshtojë ofertën dhe i kërkon Operatorit të Rrjetit që të fillojë një procedurë konsultimi dhe negocimi dhe në rast të dështimit të negociatave, të paraqesë një ankesë në përputhje me Nenin 17 të kësaj *Rregulloreje*, ose
  - c. të refuzojë ofertën. Nëse *aplikanti* nuk ndërmerr asnjë veprim brenda 15 ditëve nga marrja e informacionit, atëherë do të konsiderohet si një refuzim automatik dhe *aplikanti* do të duhet të paraqesë përsëri një aplikim të ri, në qoftë se ai është përsëri i interesuar për një *lidhje*.

- d. kur kërkesa është refuzuar, të kërkojë sqarime shtesë nga Operatori i Rrjetit në përputhje me Nenin 17 të kësaj *Rregulloreje*.

#### **Neni 16.**

#### **Zbatimi dhe vënia në operim e afateve kohore**

1. Pas nënshkrimit të *marrëveshjes për lidhje*, Operatori i Rrjetit ose drejtpërdrejt ose duke nënkontraktuar një *instalues tjetër të autorizuar të gazit* do të zbatojë punimet civile të projektit për *lidhjen* përkatëse sipas kërkesave të cilësisë të parashikuara nga legjislacioni dhe afatet e parashikuara nga kjo *Rregullore* dhe në *marrëveshjen e lidhjes*.
2. Pas përfundimit të punimeve, Operatori i Rrjetit do të testojë dhe komisionojë të gjithë instalimin e *lidhjes* së përfunduar së bashku me *instalimet e brendshme të gazit* të klientit. Vetëm pas testimit dhe komisionimit të suksesshëm, objektet e *aplikantit* do të vihen në operim.
3. I gjithë cikli që nga paraqitja e aplikimit për *lidhje* deri në momentin e vënies në operim të kategorive të ndryshme të *lidhjes* duhet të bëhen brenda afateve vijuese:
  - a) *lidhje standarde*; 3 muaj dhe në asnjë rast më shumë se 4 muaj përveç nëse është rënë dakord ndryshe ndërmjet palëve.
  - b) *lidhja në grup*; 5 muaj dhe në asnjë rast më shumë se 6 muaj përveç nëse është rënë dakord ndryshe ndërmjet palëve.
  - c) *lidhje e personalizuar*; 6 muaj ose ashtu si është rënë dakord ndërmjet *aplikantit* dhe Operatorit të Rrjetit në rastine një *marrëveshje për lidhje* të negociuar.
  - d) *lidhje e një rasti të veçantë*; në varësi të rrethanave specifike ose ashtu si është rënë dakord ndërmjet *aplikantit* dhe Operatorit të Rrjetit në rast të një *marrëveshjeje lidhjeje* të negociuar.

#### **Neni 17.**

#### **Ankesat**

1. Ne rastet kur në përputhje me Nenin 15.2.(a)(ii) dhe 15.2.(b) të kësaj *Rregulloreje*, *aplikanti* dëshiron të bëjë një vlerësim të pavarur të projektit teknik të *lidhjes* dhe ofertës financiare, ai ka të drejtën që me shpenzimet e veta të përfshijë një *instalues të autorizuar të gazit*. Operatori i Rrjetit pas marrjes së një kërkesë nga *aplikanti* do t'i vërë në dispozicion atij pa pagesë:
    - a. projektine hollësisht teknik dhe vlerësimet përkatëse të kostos së tij.
    - b. të dhënat teknike përkatëse dhe kushtet e rrjetit nën të cilat do të zbatohet *lidhja* e kërkuar.
-

- c. kërkesat minimale teknike të Operatorit të Rrjetit që duhet të përmbushen nga instalimet e reja dhe pajisjet që do të instalohen.
  - d. *pikën e lidhjes* së bashku me çdo mundësi tjetër alternative nëse është e mundur.
  - e. çdo informacion tjetër të nevojshëm për vlerësimin e duhur të çështjes siç kërkohet në mënyrë specifike dhe të arsyeshme nga *aplikanti*.
2. Pas përfundimit të vlerësimit, të dy palët do të negociojnë në mirëbesim për të arritur një marrëveshje.
3. Në rast se Operatori i Rrjetit dhe *aplikuesi* nuk arrijnë marrëveshje, *aplikanti* mund t'a paraqesë çështjen në ERE.

### **Neni 18.**

#### **Baza e të dhënave të Lidhjeve dhe Raportimi**

1. Brenda 12 muajve nga miratimi i kësaj *Rregullore*, Operatori i Rrjetit do të krijojë një bazë të dhënash elektronike (IT) për monitorimin e *lidhjeve*, e aftë të regjistrojë dhe të mundësojë aksesin nga ERE në të dhënat aktuale dhe historike për *lidhjet* për të cilat është paraqitur një aplikim dhe ato të përfunduara, së bashku me veprimet në kohë për to, produktet standarde dhe jo standarde të *lidhjeve* të ofruara, kapacitetet dhe veçoritë teknike, tarifatat e marra dhe shpenzimet e bëra, si dhe strukturën e kostos.
2. Ne vijim të krijimit të bazës së të dhënave për monitorimin e *lidhjeve* dhe në asnjë rast më vonë se dy vjet nga miratimi i kësaj *Rregullore*, Operatori i Rrjetit është e detyruar të paraqesë në ERE të dhëna dhe informacione të nevojshme për monitorimin e *lidhjeve* me rrjetet, përfshirë të dhënat dhe informacion mbi:
  - a. Numrin e aplikimeve të paraqitura, të miratuara dhe të zbatuara për t'u lidhur nga grupet e klienteve;
  - b. Numrin e klientëve të shkëputur.

### **Neni 19.**

#### **Marrëveshja e Lidhjes**

1. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj *Rregulloreje*, Operatori i Rrjetit do të hartojë dhe paraqesë për miratim në ERE *marrëveshjet e lidhjeve* të standardizuara për të gjitha llojet e kategorive të *lidhjes*.
  2. *Marrëveshjet e lidhjes* të standardizuara dhe të miratuara do të publikohen në faqen e internetit të Operatorit të Rrjetit.
  3. *Marrëveshja e lidhjes* do të përmbajë ndër të tjera:
    - a. identitetin e palëve.
    - b. detajet teknike të *lidhjes*.
    - c. skedulën e pagesave.
-

- d. skedulën e punimeve të ndertimit dhe aktivitetet përkatëse.
  - e. detyrimet e palëve.
4. Për *lidhjet e personalizuar* dhe *lidhjet erasteve të veçanta*, termat dhe kushtet e *marrëveshjes së lidhjes* mund të jenë subjekt i negociatave midis Operatorit të Rrjetit dhe *aplikantit*.

#### **Neni 20.**

##### **Aplikime të shumëfishta**

1. Në rast se pothuajse në të njëjtën kohë paraqiten më shumë se një aplikim dhe rruget e linjave përkatëse të *lidhjes* mbivendosen plotësisht, ose pjesërisht, Operatori i Rrjetit do të konsiderojë dhe/ose mundesojë një marrëveshje midis *aplikantëve* për optimizimin dhe ndarjen e kostove midis tyre, bazuar në parimin e përdorimit të ponderuar të kapacitetit të *lidhjes* dhe gjatësive përkatëse të rrjeteve që u shërbejnë klientëve.
2. Kur, në gjykimin e Operatorit të Rrjetit, përveç një *aplikanti* të vetëm ekziston mundësia që edhe palë të tjera të përdorin gaz në të ardhmen e afërt, Operatori i Rrjetit do të organizojë një takim të palëve në fjale dhe do të bëjë një vlerësim të kërkesës për gaz brenda së njëjtës zonë të rrjetit, dhe do ta marrehte në konsideratë në projektimin e *lidhjes*. Ky qëllim sidoqoftë duhet të shmangë mbipagesën për *aplikantin(tët)* e parë.

### **PJESA III: TARIFAT E LIDHJES.**

#### **Neni 21.**

##### **Kriteret për përcaktimin e tarifave të lidhjes**

- 1) Kriteret për përcaktimin e tarifave të *lidhjes* përfshijnë:
  - a) Kapacitetin e aprovuar të *lidhjes*.
  - b) Kushtet e terrenit që karakterizojnë vendndodhjen e *lidhjes* dhe nëse *lidhja* do të kryhet në mjedise urbane ose rurale.
  - c) Lloji i pajisjeve, mjeteve (përfshirë pajisjet matëse) dhe materialet e përdorura për përfundimin e një *lidhjeje* të veçantë.
  - d) Lloji i punimeve të nevojshme për t'u kryer për të mundësuar lidhjen.
- 2) Kur përcakton dhe llogarit *tarifat e lidhjes*, Operatori i Rrjetit do të përfshijë vetëm kostot aktuale, për të cilat do të japë edhe ndarjen e detajuar.

## **Neni 22.**

### **Ndarja e detajuar e kostove të lidhjes**

- 1) Ndarja e detajuar e kostove do të përfshijë:
  - a) Kostot e përgatitjes së projektit dhe të mbledhjes së dokumentacionit të kërkuar;
  - b) Kostot e blerjes së pajisjeve, mjeteve dhe materialeve të nevojshme për *lidhjen*;
  - c) Kostot e punimeve;
  - d) Kostot e punimeve specifike dhe operacionale që kërkohen për të lidhur një *objekt* me rrjetin;
  - e) Pjesa e kostove të sistemit që shkaktohen si parakusht për lidhjen e një *objekti* në rrjetin e shpërndarjes ose transmetimit (*kostot e lidhjes në gjysëm thellësi të rrjetit*); dhe
  - f) Çdo kosto tjetër që konsiderohet e nevojshme për përfundimin e *lidhjes*, ashtu si është aprovuar nga ERE.

## **Neni 23.**

### **Rregulla të përgjithshme në lidhje me tarifën e lidhjes**

- 1) Kur përcakton tarifën e *lidhjes*, Operatori i Rrjetit do të marrë parasysh parimet e *kostove të lidhjes në gjysëm thellësi të rrjetit*.
  - 2) Operatori i Rrjetit mund të përcaktojë *raportin e përdorimit të kapacitetit të rrjetit* për secilin seksion të veçantë të rrjetit, në të cilin është bërë *lidhja* individuale, ose mund të zgjedhë të përdorë një vlerë të vetme të *raportit të përdorimit të kapacitetit të rrjetit* për të gjitha pjesët e rrjetit të Operatorit të Rrjetit me presione pune poshtë dhe mbi 6 bar (përkatësisht për *lidhje standarde* dhe të *personalizuara* ose *lidhje ne grup*).
  - 3) Operatori i Rrjetit do të aplikojë tek ERE për miratimin e ndarjes së detajuar të kostove dhe tarifave përfshirë edhe *kostot e lidhjes në gjysëm thellësi të rrjetit* (për cdo kategori *lidhjeje*) jo më vonë se 18 muaj nga hyrja në fuqi e kësaj *Rregullore*.
  - 4) Për cdo vit pasardhës pas miratimit të parë sipas paragrafit 3 më sipër, Operatori i Rrjetit do të paraqesë në ERE për miratim jo më vonë se data 30 nëntor, ndarjen e detajuar të kostove dhe tarifave përfshirë edhe *kostot për lidhjen në gjysëm thellësi të rrjetit* (për cdo kategori *lidhjeje*) përpara zbatimit të tyre gjatë vitit në vijim.
  - 5) Pas aprovimit të tarifave të *lidhjes*, Operatori i Rrjetit do të bëjë shpalljen e tyre nepermjet publikimit në faqen e tij të internetit.
-

- 6) Operatori i Rrjetit mund të bëjë zbritje dhe ofroje kushte te vecanta pagese për tarifat e lidhjes, por të tilla përfitime do t'ju ofrohen të gjithë përdoruesve të mundshëm në të njëjtat kushte.
- 7) Projekti i lidhjes i përgatitur nga Operatori i Rrjetit dhe pranuar nga aplikanti dhe çmimi përkatës që do të paguhet për lidhjen kur është rënë dakord do të jenë përfundimtar, përveç rasteve që është rënë dakord ndryshe në marrëveshjen e lidhjes midis palëve. Çdo ndryshim i projektit të lidhjes si rezultat i modifikimeve të mëvonshme të bëra në mënyrë të njëanshme nga Operatori i Rrjetit gjatë zbatimit të tij nuk do të rezultojë në kosto shtesë për aplikantin.

#### Neni 24.

##### Përcaktimi i tarifave standarde të lidhjes

- 1) Në varësi të kapacitetit maksimal të lidhjes, ose llojit të matësit, përcaktohen llojet e mëposhtme të lidhjeve:

Lloji i Matesit	Kapaciteti maksimal
G-4	40 kW
G-6	60 kW
G-10	100 kW

- 2) Tarifat standarde të lidhjes përfshijnë të gjitha kostot që kanë të bëjnë me ndërtimin e lidhjes nga pika e lidhjes deri në pikën e matjes dhe përcaktohen për secilin lloj të një lidhjeje standarde sipas paragrafit (1) më lart, mbi bazën e:
  - a) Kostos mesatare vjetore të përgatitjes së projektit dhe mbledhjes së dokumentacionit të kërkuar për lidhjen standarde të një lloji të veçantë. Për qëllim të vlerësimit të tarifave për vitin e parë, Operatori i Rrjetit mund të përdorë vlerësime kostoje të arsyeshme dhe të detajuara;
  - b) Sasive mesatare vjetore të standardizuara të pajisjeve, mjeteve dhe materialeve të nevojshme për instalimin e lidhjeve standarde të një lloji të veçantë;
  - c) Kostos mesatare vjetore të punimeve për ndërtimin e lidhjes standarde të një lloji të veçantë, dhe
  - d) Kostos mesatare vjetore të punimeve specifike dhe operacionale që kërkohen për të lidhur objektet me rrjetin.
- 3) Tarifat e lidhjes standarde do të ndahen në dy grupe:

- a) Tarifë fikse e *lidhjes standarde*, për cdo lloj *lidhjeje standarde* në një *distancë nga rrjeti* deri në 20 metra; dhe
- b) Tarifë e ndryshueshme e *lidhjes standarde*, e cila do të varet nga gjatësia shtesë për çdo *distancë nga rrjeti* që tejkalon 20 metra. Tarifa e ndryshueshme e *lidhjes standarde* duhet të shprehet për çdo metër *distancë* për secilin lloj të *lidhjeje standarde*.
- 4) Operatori i Rrjetit ka të drejtë të ngarkojë tarifën Fikse të *lidhjes standarde* për secilin lloj të *lidhjeje standarde*, përfshirë rastet kur distanca nga rrjeti është më e shkurtër se 20 metra.
- 5) Ndarjet e detajuara të kostos së *lidhjes* dhe tarifat e *lidhjes* - të dyja për secilin lloj të *lidhjeje standarde* - do të miratohen nga ERE para aplikimit të tyre.

## Neni 25.

### Përcaktimi i tarifave për lidhjet e personalizuar

Tarifat për *lidhje të personalizuar* janë të barabarta me shumën e kostove aktuale të:

- a) Përgatitjes së projektit;
  - b) Mbledhjes së dokumentacionit të nevojshëm, lejet e dhëna nga të gjitha autoritetet përkatëse dhe/ose miratimet e tyre;
  - c) Shpenzimeve të pronës për një *lidhje* të veçantë, nëse kjo do të ishte e nevojshme;
  - d) Kryerjes së punimeve përgatitore të nevojshme për realizimin e *lidhjes*;
  - e) Blerjes së pajisjeve, mjeteve dhe materialeve të nevojshme për realizimin e *lidhjes*;
  - f) Punëtorëve të angazhuar në ndërtim, makinerive dhe punimeve elektrike që lidhen me ndërtimin e një *lidhjeje*, përdorimin e makinerive të drejtuara nga operatori, mjetet speciale dhe pajisjet, dhe përdorimin e automjeteve me shofer;
  - g) Pajisjes së *pikës së matjes*;
  - h) Projektimit gjeoteknik dhe gjeodezik të rrugës, studimeve të rrugës së *lidhjes* dhe përditësimit të librave kadastral të tubacionit dhe modifikimet në hartat përkatëse kadastrale;
  - i) Komisionimit dhe vënies në punë;
  - j) Kryerjes së punimeve të tjera të specializuara dhe operacionale që kërkohen për të lidhur një *objekt* në rrjet: vizitat në vend për të identifikuar vendndodhjen e objekteve, rrjeteve dhe rrugëve të *lidhjes*; mbikëqyrjes profesionale të ndërtimit, montimit të makinerive dhe punimeve në tubacionet e gazit; dhe kontrollit teknik të *instalimeve të brendshme të gazit* para furnizimit fillestar me gaz të *lidhjes*, në përputhje me Rregulloren Teknike dhe Kodin e Rrjetit me të cilin do të lidhet *objekti* dhe kriteret e specifikuar në këtë *Rregullore*.
-

## Neni 26.

### Përcaktimi i tarifave për lidhjet ne grup

- 1) Kostot e *lidhjes në grup* përcaktohen sipas të njëjtës metodologji si për *lidhjet e personalizuar*.
- 2) Tarifat e *lidhjes* bazohen në koston e *lidhjes në grup* të ponderuara me numrin e pajisjeve matëse individuale dhe kapacitetit të instaluar brenda *objektit*.
- 3) Kostoja e përgjithshme e *lidhjes në grup* mund të mbartet fillimisht nga pronari i *objektit* dhe t'i kthehet atij më vonë nga pronarët/përdoruesit e apartamenteve/zyrave individuale, bazuar në parimet e tarifimit sipas paragrafit 2) më lart.

## Neni 27.

### Përcaktimi i tarifave të lidhjes për rastet e vecantë

- 1) Tarifat për *lidhje të rasteve të vecantë* përcaktohen sipas metodologjisë së mëposhtme:
  - a) *Kostot e lidhjes në gjysëm thellësi të rrjetit* që kanë të bëjnë me një *lidhje të një rasti të veçantë* përcaktohen vetëm për rritjen e kapacitetit të aprovuar;
  - b) Në masën kur ekziston nevoja për të zëvendësuar *pajisjen matëse* (për shembull, në rastet kur matësi ekzistues ka tejkalar 50% të jetës së tij), do të jetë kostoja e pajisjes së re matëse;
  - c) në rast të modifikimeve të një *lidhje*, tarifat e *lidhjes* përcaktohen bazuar në kostot aktuale shtesë të bëra për realizimin e një *lidhjeje* të tillë;
  - d) kur *lidhja* e një *objekti* bëhet pas një shkëputje të detyruar, tarifat e *lidhjes* përcaktohen bazuar në kostot aktuale shtesë të bëra për realizimin e një *lidhjeje* të tillë;
  - e) Në rast të një *lidhjeje* të re, për shkak të zhvendosjes ose prishjes së një *objekti* që ka qenë i lidhur më parë dhe që nuk është iniciuar nga Operatori i Rrjetit, aplikohet i njëjti rrjet i tarifimit si për *lidhjen* origjinale. Megjithatë, në raste të tilla, në atë masë që disa elementë të lidhjes ekzistuese (të zhvendosura ose prishura) mund të ripërdoren pa cënuar sigurinë për qëllimin e *lidhjes* së re, këto kosto do të zbriten.



## **PJESA V: PRONËSIA E LIDHJES**

### **Neni 28.**

#### **Kufijtë e pronësisë**

Përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe në *marrëveshjen e lidhjes* midis Operatorit të Rrjetit dhe *aplikantit*, asetet e *lidhjes* pasi të jenë përfunduar, testuar dhe komisionuar dhe të jenë bërë operacionale nga *pika e lidhjes* e deri në *pikën e matjes*, përfshirë pajisjen matëse, do të jenë pronë e Operatorit të Rrjetit.

## **PJESA VI: DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 29.**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që lind si rezultat i mos zbatimit të kësaj *Rregullore* do të trajtohet nga ERE në përputhje me "Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror".

### **Neni 30.**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo *Rregullore* hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë.